URDHËR
Nr. 154, datë 13.4.2012

PËR HAPJEN E NJËSIVE KRYESORE PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "VITRINA"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 5 dhe 6 të nenit 41 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 608, datë 6.5.2009 "Për licencimin e shkollës së lartë private "Vitrina",

URDHËROJ:

1. Hapjen e njësive kryesore pranë shkollës së lartë private "Vitrina" në përputhje me vendimin nr. 317, datë 16.3.2012 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë "Për hapjen e njësive kryesore me emërtimet Fakulteti i Arkitekturës, Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Shkencave të Edukimit në shkollën e lartë private "Vitrina", Tiranë" (bashkëlidhur këtij urdhri) si vijon:

a) Fakulteti i Arkitekturës;
b) Fakulteti i Mjekësisë;
c) Fakulteti i Shkencave të Edukimit.

2. Fakulteti i Arkitekturës të ketë në përbërje këto njësi bazë:

a) Departamenti i Arkitekturës;
b) Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
c) Departamenti i Formimit të Përgjithshëm.

3. Fakulteti i Mjekësisë të ketë në përbërje këto njësi bazë:

a) Departamenti i Mjekësisë së Përgjithshme;
b) Departamenti i Stomatologjisë;
c) Departamenti i Farmacisë;
d) Departamenti i Infermierisë.

4. Fakulteti i Shkencave të Edukimit të ketë në përbërje këto njësi bazë:

a) Departamenti i Sociologjisë;
b) Departamenti i Ciklit të Ulët e Parashkollor;
c) Departamenti i Gjuhëve të Huaja.

5. Ky institucion duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë private "Vitrina".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj